



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 12/2018 “PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI

Në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

1. Në tërësi të ligjit emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore”.
2. Në tërësi të ligjit togfjalëshi organi i/organet e Vlerësimit zëvendësohet me trupa/trupat e vlerësimit.
3. Togfjalëshi “vetëvlerësim profesional” zëvendësohet me “vlerësim profesional”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Pikat 1 dhe 3 shfuqizohen.

2. Shtohet pika 3.1,3.2 dhe 3.3 si vijon:

“3.1. “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore” është institucioni përgjegjës për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.”

“3.2. “Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në vijim të këtij ligji do të njihet si “ILDKPKI”

“3.3. “Informacion i klasifikuar” është çdo dokument ose material, pavarësisht nga forma, natyra ose mënyra e transmetimit të tij, i përgatitur ose që përgatitet, për të cilin është vendosur një nivel i caktuar klasifikimi në interes të sigurisë kombëtare dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që kërkon mbrojtje ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapjeje, humbjeje ose aksesit të ndonjë individi të paautorizuar dhe çdo lloj tjetër kompromentimi sigurie.”

3. Pika 5 riformulohet si vijon:

“5. Kontakt i papërshtatshëm” është një takim, komunikim verbal apo elektronik i vazhdueshmëm dhe i qëllimshëm, që nuk përputhet dhe/ose nuk ka lidhje me ushtrimin e detyrës nga punonjësi, të vërtetuar dhe dokumentuar si një marrëdhënie e konsoliduar me ndikim në vullnetin e subjektit në kuptim të këtij ligji”

4. Pika 8, riformulohet si vijon:

“8. “Niveli i besueshëm në kontrollin e figurës” është konstatimi, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, se subjekti është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës, sipas përcaktimeve të këtij ligji.”

5. Në pikën 10 pjesa e fjalisë “organet e vlerësimit konsultohen gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të vlerësimit dhe vlerësimit kalimtar të punonjësve” zëvendësohet me “trupat e vlerësimit konsultohen për aspekte teknike të vlerësimit të punonjësve”

6. Pika 13, riformulohet si vijon:

“13. “Person i përfshirë në krimin e organizuar” ka të njëjtin kuptim, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.”

7. Pika 16 riformulohet si vijon:

“16. Punonjës i AMP” është personi i emëruar në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas legjislacionit në fuqi.”

8. Pika 23 riformulohet si vijon:

“23. “Krim i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni” përfshijnë veprat penale sipas nenit 75/a të Kodit Procedurës Penale”.

9. Pika 24 riformulohet si vijon:

“Procesi i vlerësimit” përfshin si vlerësimin kalimtar, ashtu edhe vlerësimin periodik të subjekteve të vlerësimit”.

Neni 3

Shtohet neni 3/1 dhe 3/2 si vijon:

“Neni 3/1

Parimet e vlerësimit

1. Procesi i vlerësimit kalimtar dhe periodik bazohet në parimet e mëposhtme:
 - a. ligjshmëria;
 - b. pavarësia objektiviteti dhe paanshmëria;
 - c. profesionalizmi dhe ndershmëria në ushtrimin e detyrave;
 - d. transparenca;
 - e. shmangia e konfliktit të interesit;

- f. proporcionaliteti;
- g. ruajtja e konfidencialitetit dhe sekretit hetimor;
- h. llogaridhënia;
- i. mosdiskriminimi dhe barazia gjinore;
- j. respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut
- k. deburokratizimit dhe i efijencës
- l. ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit
- m. marrjes së vendimeve duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.”

“Neni 3/2

E drejta e Informimit

E drejta e informimit, e parashikuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, mund të kufizohet nga Trupa e Vlerësimit ,e cila i kërkon mendim me shkrim Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.”

Neni 4

Në nenin 4 bëhen ndryshime si vijon: shfuqizohet pika “2” dhe “3” e tij.

Neni 5

Neni 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 5

Institucioni përgjegjës i vlerësimit

1. Institucioni përgjegjës për procesin e vlerësimit është Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, e cila organizon trupa vlerësimit për këtë qëllim.
2. Trupat e Vlerësimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, zbatojnë procedurat e parashikuara në këtë ligj, në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale” dhe në Kodin e Procedurave Administrative.
3. Trupat e Vlerësimit janë të organizuara në formën e organit kolegjial përgjegjëse për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj subjekteve që do të vlerësohen, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
4. Trupa e vlerësimit përbëhet nga tre anëtarë, të cilët caktohen me short. Relatori i trupës së vlerësimit caktohet me short.
5. Anëtarët e trupave të vlerësimit pajisen me certifikatë sigurie, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet e trajtimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.
6. Punonjësit, për tu vlerësuar nga trupa e vlerësimit, caktohen sipas një shorti, duke filluar nga funksionet më të larta.

7. Procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.”

Neni 6

Neni 6, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 6

Fushat e ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore vlerëson punonjësit në pozicionet e mëposhtme:
 - a. drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor në strukturat e vecanta, drejtor e zëvendësdrejtor vendor, drejtor në drejtoritë e kufirit dhe migracionit, shef komisariati, shef sektori në nivel qendror e vendor që mbulon fushën e krimit të organizuar, krimit ekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit.
 - b. drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie dhe shef njësie në Gardën e Republikës;
 - c. drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, shef sektori në nivel qendror dhe vendor në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.
 - d. punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimit kalimtar/periodik në AMP.
 - e. çdo punonjës që emërohet në pozicionet e përcaktuara në shkronjat a, b, c dhe d të këtij neni bëhet subjekt i vlerësimit kalimtar.
2. Subjektet e vlerësimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kanë detyrimin të plotësojnë dhe të dorëzojnë formularët e deklaramit të pasurisë të miratuara me urdhër të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Inspektorit të Përgjithshëm, si dhe formularët e deklaramit të kontrollit të figurës dhe profesionalizmit, të miratuar me urdhër të Ministrit të Brendshëm brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e urdhrit ose nga data e emërimit në funksionet e sipërpërmendura.

Neni 7

1. Kreu II ndryshon emërtimin si vijon: “Përbërja dhe organizimi i strukturës së vlerësimit”.
2. Seksioni I, ndryshon emërtimin si vijon: Trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”

Neni 8

Neni 7, 8 dhe neni 9 shfuqizohen.

Neni 9

Në nenin 10 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Shkronja “a”, ndryshohet si më poshtë vijon:

a. të ketë diplomë diplomë të nivelit “Master shkencor” në shkencat juridike dhe ose ekonomike”

2. Shkronja “b”, ndryshohet si vijon:

“b. Ka eksperiencë pune jo më pak se 4 vjet në profesion.

3. Shkronja “ë”, e pikës 1, pika 2 dhe 3, shfuqizohen.

Neni 10

Nenet 11,12 dhe 13 shfuqizohen.

Neni 11

Seksioni IV ndryshon emërtimin si më poshtë vijon :

“Seksioni IV

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtuesit dhe anëtarëve të Trupave të Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”

Neni 12

Neni 24, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 24

Drejtuesi i Trupave të Vlerësimit

1. Trupat e Vlerësimit drejtohen nga Drejtuesi i Strukturës së Vlerësimit.
2. Drejtuesi i Trupave të Vlerësimit ka këto kompetenca:
 - a) përgatit, thërret dhe drejton mbledhjen e anëtarëve;
 - b) drejton procedurën e hedhjes së shortit të anëtarëve të trupave të vlerësimit;
 - c) përfaqëson trupat e vlerësimit në marrëdhënie me të tretët;
 - ç) bashkërendon punën në trupat e vlerësimit;
 - d) propozon titullarit të institucionit projekt-akte, programe, dokumenta strategjike apo materiale të ndryshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së trupave të vlerësimit;
 - dh) nënshkruan të gjitha aktet e trupave të vlerësimit, me përjashtim të vendimeve për rezultatin e vlerësimit, të cilët nënshkruhen nga trupat e vlerësimit;
 - e) merr masa për sigurimin e kushteve optimale për zhvillimin e veprimtarisë së trupave të vlerësimit;
 - ë) merr masa për vendosjen dhe sigurimin e bashkëpunimit midis institucioneve për sigurim informacioni;
 - f) mbikëqyr ecurinë e procesit administrativ dhe respektimin e afateve nga trupat e vlerësimit;
 - g) kryen detyra të tjera, administrative dhe kordinuese në interes dhe në mbështetje të procesit të vlerësimit në tërësi.”

Neni 13

Në nenin 25, shkronja d e pikës 1 shfuqizohet.

Neni 14

Neni 26 shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 27 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në titullin e nenit, emërtimi “Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit” zëvendësohet me “Grupave të Vlerësimit”.
2. Në pikën 1 togfjalëshi “marrjen e detyrës” zëvendësohet me “pranimin e dosjes së subjektit nga ana e”.
3. Pika 2, riformulohet si vijon:
“2. Anëtari i trupave të vlerësimit, përveç shkejeve të normuara në ligjin organik të AMP-së, përjashtohet nga detyra/ndërpret marrëdhëniet e punës edhe në rastet e:
3. Në shkronjën c të pikës 2, togfjalëshi “të kryetarit ose të organeve kompetente” zëvendësohet me “të drejtuesit të strukturës”.

Neni 16

Neni 28 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 28

Procedurat për përjashtimin e anëtarëve të Grupave të Vlerësimit

1. Në rast se ka të dhëna të mjaftueshme, nga burime të vërtetuara, se anëtari ka kryer një shkelje disiplinore, ndaj tij fillon hetimi disiplinor nga një komision disiplinor sipas ligjit organik të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
2. Anëtari i trupave të vlerësimit, i cili i nënshtrohet procedimit disiplinor, ka të drejtë të informohet, të mbrohet dhe të dëgjohet gjatë procedimit disiplinor.
3. Në përfundim të procedurës, komisioni disiplinor vendos për përjashtimin ose jo të anëtarit, ndaj të cilit zhvillohet procedimi disiplinor.
4. Për zëvendësimin e anëtarit të shkarkuar caktohen në detyrë anëtarët zëvendësues dhe, në rast pamjaftueshmërie, zbatohen procedurat e parashikuara për përzgjedhjen e tij.”

Neni 17

Nenet 29 dhe 30 shfuqizohen.

Neni 18

1. Pika 1 e nenit 32 si më poshtë vijon:

“1.Subjekti i vlerësimit deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.”

2. Shtohet pika 1.1 e nenit si vijon:

“1.1.Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim.”

3. Në pikën 2 të nenit, togfjalëshi “këtij ligji” zëvendësohet me togfjalëshin “e Urdhërit të Ministrisë të Brendshme ose nga data e emërimit në funksionet objekt vlerësimi”.

4. Në pikën 3 të nenit 32 fjala “detyra” zëvendësohet nga togfjalëshi “pozicionet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji”.

5. Në pikën 5 të nenit 32 fjala “mund” zëvendësohet nga fjala “duhet”.

Neni 19

Në nenin 33 ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Subjekti, i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron:

- a. Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të zotëruara nga subjekti i vlerësimit, apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë, si dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, si më poshtë vijon:
 - ii. pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
 - iii. pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to;
 - iv. sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 lekë;
 - v. vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
 - vi. vlerën e likuiditeteve, gjendje në Cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari, në huadhënie, apo mjete të tjera financiare, në lekë ose në valutë të huaj.
- b. Angazhime në veprimtari private dhe/ose publike me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie e kryer brenda dhe jashtë vendit që ka krijuar të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, licenca dhe patenta që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë tjetër;

- të subjektit të vlerësimit, të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es dhe fëmijëve në moshë madhore, për periudhën deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private.
- c. Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të deklaratës së interesave private.
 - d. Shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij apo të personave të lidhur.
 - e. Udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen, shpenzimet e përballuara.
 - f. Arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklarimit, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve për 10 vitet e fundit.
2. Të gjitha subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët në moshë madhore, të cilët bëhen subjekte të këtij ligji dhe plotësojnë deklaratën e pasurisë, nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në Cash jashtë sistemit bankar mbi shumën 1,5 milion lekë. Depozitimi në institucionet bankare i gjendjeve Cash mbi vlerën 1,5 milion lekë është i detyrueshëm përpara dorëzimit të deklaratës së pasurisë pranë njësisë së burimeve njerëzore.
 3. Nëse subjekti i vlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë trupave të vlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë të tjera. Trupat e vlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.
 4. Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 32 të këtij ligji. Ndërsa për personat e tjerë të lidhur në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, detyrimin për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisëve e ka subjekti i vlerësimit”.

Neni 20

Shtohet neni 33/1, si më poshtë vijon:

“Neni 33/1

Procedura e vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI

1. Pas dërgimit të listave me emrat e subjekteve të vlerësimit të shortuar, deklaratave të pasurive dhe dokumentacionin që shoqëron ato pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, kjo e fundit kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklaratimit brenda 120 ditëve.
2. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave

të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

3. Në përfundim të kontrollit ILDKPKI, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklarim i rremë;

d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

dh) deklarimi është i pasaktë, mungesë dokumentacioni justifikues.

4. Në rastet e përcaktuara në pikën 3, shkronja “dh”, ILDKPKI, duhet të argumentojë dhe arsyetojë saktësisht në raport, llojin e pasurive që nuk kanë dokumentacion justifikues, dhe kohën e krijimit të tyre.”

Neni 21

Në nenin 34, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon dhe rinumërohet si pikë 1:

“1. ILDKPKI-ja vë në dispozicion raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar që ka përgatitur sipas nenit 33/1 të këtij ligji.”

3. Shtohet pikat 3.1 si vijon:

“3.1 Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore kryejnë verifikim të pavarur sipas procedurave të përcaktuara në këtë nen, brenda 60 ditëve nga vënia në dispozicion e raportit të ILDKPKI-së, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë dhe merr vendim.”

4. Shfuqizohet pika 4 e nenit 34.

5. Në shkronjën “b”, të pikës 6, hiqet togfjalëshi “kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”.

Neni 22

Neni 35 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 35

Objekti i kontrollit të figurës

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

Neni 23

Në nenin 36, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, fjala “tij” zëvendësohet me togfjalëshin “urdhër të Ministrit të Brendshëm, ose nga data e emërimit në funksionet objekt vlerësimi”.
2. Në pikën 2 zëvendësohet togfjalëshi “komisionin përkatës” me “institucionin”.
3. Në shkronjën “dh”, e pikës 3 të nenit 36, emërtimi “Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” zëvendësohet me emërtimin “Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”.

Neni 24

Në nenin 37, bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:

1. Reformulohet pika 1, si vijon:

“1. Për kontrollin e figurës së punonjësit, institucioni i vlerësimit i drejtohet Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimit Informativ të Shtetit, Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, Agjencisë së Mbikëqytjes Policore, strukturave apo njërive të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për informacione ose të dhëna të tjera që mund të kenë këto institucione, apo shërbimeve të tjera informative, brenda vendit.”

2. Shfuqizohen pikat 2 dhe 3.

Neni 25

Neni 38 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 38

Vlerësimi i rrethanave për kontrollin e figurës

1. Për kontrollin e figurës, trupat e vlerësimit verifikojnësi më poshtë:
 - a) identitetin në të shkuarën dhe të tashmen për çdo punonjës, që i nënshtrohet kontrollit dhe arsyen e ndryshimeve të emrit, mbiemrit apo gjenealiteteve të tjera;
 - b) të dhënat për vendbanimin aktual e të mëparshëm, brenda dhe jashtë vendit;
 - c) rastet e ndryshimeve ose të marrjes së shtetësive të tjera;

- ç) ndalimin për hyrje në vendet e Bashkimit Europian ose të NATO-s;
 - d) kërkesën për azil në ndonjë shtet;
 - dh) procedimet penale dhe administrative ndaj punonjësit, brenda dhe jashtë vendit, sipas përcaktimeve të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike;
 - e) dëbimin nga shtete të tjera, për shkelje të rregullave të hyrjes apo qëndrimit;
 - ë) nëse janë përdorues të lëndëve narkotike;
 - f) varësinë nga alkooli apo nga lojërat e fatit;
2. Punonjësi i nënshtrohet testimit për përdorim lëndësh narkotike, rezultatet e të cilave vlerësohen së bashku me rrethanat e tjera.”

Neni 26

1. Pika 1, e nenit 39, riformulohet si më poshtë vijon:

“1 Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova, informacione të klasifikuara dhe të dhëna të tjera, në kuadër të dyshimit të arsyeshëm, bazuar në informacione të vërtetuara nga burime të ligjshme.”

2. Në shkronjën b të pikës 4 hiqet fjala “të ngushta”.

Neni 27

Në nenin 40 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijonë:

1. Shfuqizohet shkronja “a”.
2. Në pikën b pas fjalës “bazuar” shtohet fjala “në ligj”
3. Shtohen shkronjat “c” dhe “ç” si më poshtë:
“c) kur personi i dëbuar nga shtetet e tjera është shpallur i padëshiruar;
ç) subjekti i vlerësimit është përdorues apo ka varësi nga lëndët narkotike.”

Neni 28

Neni 42 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 42

Procedura për kontrollin e figurës

1. Për kontrollin e figurës, struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore brenda 120 ditëve përgatit një raport të hollësishëm e të arsyetuar dhe e paraqit pranë trupave të vlerësimit.
2. Trupa e vlerësimit, brenda 60 ditë, nga vënia në dispozicion e raportit, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë, verifikon nëse informacioni i deklaruar është i saktë dhe i besueshëm, në kuadër të dyshimit të arsyeshëm dhe në informacionet e vërtetuara, si dhe nëse punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

3. Në përfundimin e procesit të kontrollit të figurës, trupa e vlerësimit përgatit raportin e arsyetuar, në të cilin përcaktohet nëse subjekti është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës kur:
- a) punonjësi ka kryer deklaram të rremë;
 - b) ka informacione të dhëna të vërtetuara nga agjensitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;
 - c) ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
4. Ky raport përmban informacion për kontaktin e punonjësve dhe nuk bëhet publik, nëse ai rrezikon sigurinë e burimit të informacionit ose për shkak të rrethanave të tjera objektive. ”

Neni 29

1. Në pikën 1 të nenit 44, fjala “tij” zëvendësohet me togfjalëshin “urdhërit të Ministrit të Brendshëm, ose në datën e emërimit në funksionet objekt vlerësimi.”
2. Në pikën 2 dhe 3 të këtij neni “7 vjet” zëvendësohet me “5 vjet”.

Neni 30

Neni 45 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 45

Burimet për vlerësimin e aftësive profesionale

1. Aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar në legjislacionin e përkatës që rregullon marrëdhënien e punës së subjektit të vlerësimit dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.
2. Në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë:
 - a. arsimit i punonjësit;
 - b. diplomat;
 - c. certifikatat e trajnimeve dhe medaljet;
 - d. vlerësimet e punës;
 - e. masat disiplinore;
 - f. ecuria në karrierë.
3. Nuk përbëjnë burim vlerësimi profesional aktet procedurale të procedimeve penale në proces apo ato që përbëjnë sekret hetimor.”

Neni 31

Në nenin 46 behën këto shtesa dhe ndryshime si më poshtë vijon:

1. Riformulohet pika 2:

“2. Për komponentin e aftësive profesionale, struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardeve profesionale, bazuar në vlerësimet e punës dhe indikatorët e përcaktuar në nenin 45 të këtij ligji, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale brenda 120 ditëve nga kërkesa e dërguar nga trupat e vlerësimit.”

2. Pika 3 dhe 5 shfuqizohet.

Neni 32

1. Neni 47 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 47

Raporti përfundimtar i vlerësimit profesional

1. Në përfundim të procesit të vlerësimit të aftësive profesionale, trupa e vlerësimit, brenda 60 ditëve, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë, nga vënia në dispozicion e raportit të strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore/standardeve profesionale, , si dhe bazuar në formularin e vlerësimit, përgatit raportin përfundimtar të arsyetuar dhe vendos nëse punonjësi është:

- b) “I përshtatshëm”, kur punonjësi ka arsimin/trajnimin përkatës për funksionin, vlerësime pozitive pune dhe ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.
- c) “Me mangësi”, kur punonjësi nuk ka arsimin/trajnimin përkatës për funksionin që kryen, ka vlerësime “dobët” pune dhe ka rezultuar i pakualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, trupa e vlerësimit i rekomandon titullarit të institucionit përkatës që punonjësi të largohet nga kategoria e pozicioneve të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji.”

Neni 33

Shtohet neni 47/1, si më poshtë vijon:

“Neni 47/1

Pananshmëria e Trupave të Vlerësimit

Grupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, të udhëhequra nga parimi i proporcionalitetit, paanshmërisë dhe ligjshmërisë, janë të pavarura dhe të paanashme në vendimmarrjen e tyre.”

Neni 34

Në pikën 3 të nenit 51, pas fjalës “vlerësojnë” shtohet togfjalëshi “dhe vërtetojnë”.

Neni 35

Në nenin 52, bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

- 1. Në pikën 1 togfjalëshi “Antarët dhe”, “ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” hiqet.
- 2. Në shkronjën “c”, të pikës 1 dhe pikën 6 hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
- 3. Në pikën 2 hiqet emërtimi “të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit”.

4. Shfuqizohet pika 6 e këtij neni.

5. Në pikën 7, togfjalëshi “Anëtarët e organeve të vlerësimit” zëvendësohet me togfjalëshin “Antarët e Trupave të Vlerësimit të AMP-së”.

Neni 36

Në nenin 53 pas fjalës “informacionet” shtohet togfjalëshi të “vërtetuara në mënyrë ligjore”

Neni 37

Shtohet neni 53/1, si më poshtë vijon:

“Neni 53/1

Barra e provës

1. Trupa e vlerësimit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqet nga parimi i objektivitetit, ligjshmërisë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.
2. Nëse trupa e vlerësimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 48, të këtij ligji, subjekti i vlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.
3. Parashikimet e nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative nuk zbatohen.”

Neni 38

Në nenin 54 bëhen disa ndryshime si më poshtë vijon:

1. Reformulohet pika 2, si më poshtë vijon:
“2. Institucionet publike apo agjencitë ligjzbatuese që disponojnë apo mund të mbledhin informacion për subjektet e vlerësimit të nenit 6 të këtij ligji, e dorëzojnë këtë informacion pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.”
2. Shfuqizohet pika 3 dhe në pikën 4 të tij zëvendësohet togfjalëshi “komisioneve të vlerësimit” me “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

Neni 39

Neni 55, zëvendësohet fjala “organi” me “trupat”, si dhe fjala “Komisioni” zëvendësohet me “Agjencia e Mbikëqyrjes Policore”.

Neni 40

1. Në pikat 1, 4, 5 dhe 6 të nenit 56 shfuqizohet emërtimi “ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
2. Pika 7, togfjalëshi “anëtar i sekretariatit teknik” zëvendësohet me “anëtar i trupës së vlerësimit”.

Neni 41

Neni 57 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 57
Dorëheqja nga detyra

1. Kur punonjësi jep dorëheqjen ose akti i lirimit formalizohet gjatë fazës së hetimit administrativ, trupa e vlerësimit merr vendim për ndërprerjen e procesit të vlerësimit pa një vendim përfundimtar sipas Kodit të Procedurës Administrative.”

Neni 42

Neni 58, pika 3 shkronja b riformulohet si më poshtë vijon:

“b) trupën e vlerësimit, që ka shqyrtuar çështjen;”

Neni 43

Në nenin 59 bëhen disa shtesa dhe ndryshime si më poshtë vijon:

1. Hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
2. Shfuqizohen shkronjat “b” dhe “c” të nenit 59.
3. Shtohet pika a.1 “rekomandimin drejtuar titullarit të institucionit për të larguar punonjësin nga kategoria e pozicioneve objekt vlerësimi;”

Neni 44

Në pikën 2 të nenin 60 hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

Neni 45

Neni 61 shfuqizohet.

Neni 46

1. Në pikën 62, hiqet emërtimi “Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.
2. Shfuqizohet gërma “a” dhe “dh”.
3. Shkronja “d” e nenit 62, riformulohet si vijon:
“d) rezulton i papërshtatshëm nga kontrolli i figurës.”

Neni 47

Shtohet neni 62/1, si më poshtë vijon:

“Neni 62/1

Detyrimi i institucionit për zbatimin e vendimit

1. Institucionet e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore kanë detyrimin e ekzekutimit/zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.
2. Në rastet kur mospërbushja e pikës 1 të këtij neni nuk përbën përgjegjësi penale, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore.”

Neni 48

1. Reformulohet emërtimi i nenit 64 si vijon:

“Trajnimi paraprak i anëtarëve të Trupave të Vlerësimit”

2. Në nenin 64 togëfjalëshi “Anëtarët e komisioneve të vlerësimit dhe sekretariateve teknike pranë tyre” zëvendësohet me togëfjalëshin “Anëtarët e Trupave të Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
3. Shuqizohet pika 2 e nenit 64.

Neni 49

Neni 65 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 65

Vlerësimi periodik i punonjësve

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve, sipas këtij ligji, punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore do t’i nënshtrohen deklaramit dhe vlerësimit periodik çdo 5 vjet.
2. Objekti, parimet, procedura dhe vendimmarrja për vlerësimin periodik në kriterin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale është e njëjtë me atë të vlerësimit kalimtar, të përcaktuara në këtë ligj.
3. Punonjësit që parashikohen në nenin 6, janë të detyruar të plotësojnë formularët, shtojca të këtij ligji, çdo 5 vjet. Formularët dorëzohen në njësinë e burimeve njerëzore të institucioneve përkatëse, e cila i mban në ruajtje dhe i përcjell pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për vlerësim periodik.
4. Në deklaratat që plotësohen gjatë vlerësimit periodik, punonjësit deklarojnë vetëm ndryshimet që kanë ndodhur gjatë periudhës nga vlerësimi kalimtar.

5. Instrukcioni që bën verifikimin e të dhënave të deklaruar nga punonjësit, sipas formularëve përkatës është Agjencia e Mbikëqyrjes Policore. Për këtë qëllim, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

6. Rregullat për organizimin e shortit për punonjësit që do t'i nënshtrohen verifikimit dhe procedura e kryerjes së verifikimit për vlerësimin periodik nga trupat e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.”

Neni 50

Në nenin 66, shfuqizohet pika 1 dhe riformulohet pika 2 dhe shtohet pika 3 si vijon:

1. Ngarkohet Ministri i Brendshëm që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 6, pikës 7 të nenit 5 dhe pikës 6 të nenit 65 të këtij ligji
2. Ngarkohet Ministri i Brendshëm dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së që, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë urdhërin në zbatim të pikës 2 të nenit 6.

Neni 51

Neni 68 ndryshohet si më poshtë vijon:

Neni 68 Dispozitë kalimtare

1. Veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit përfundon me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Formularët e deklarimeve të plotësura më parë, administrohen nga strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore të çdo institucioni.”

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

LINDITA NIKOLLA